



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:072151

Datë: 25.02.2021

Numri i dokumentit: 01543297

P.nr.1/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. H. Rahovecit, për shkak të veprës penale të asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, në vazhdimësi, nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale të sulmit nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1759/2018 të datës 26.12.2018, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 19.01.2021, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Kastriot Memaj, të akuzuarit si dhe të dëmtuarit A. H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.21.01.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

H. H., nga i ati S., dhe e ëma S., e lindur Sh., i lindur me dt...., në Rahovec, ku dhe tani jeton, Rr."Sh. Z.", p.nr., me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor fizik, i papunë, i pamartuar, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale,

ËSHTË FAJTOR

I

Sepse, me dt.25.11.2018, rreth orës 01:30min, në Rahovec në rrugën "Sh. Z." pn., në gjendje të dehur prej 1.57 promila alkool në gjak, vëllait të tij të dëmtuarit M. H. nga Rahoveci, rruga "Sh. Z." pn., i shkakton dëm material në shtëpi, në atë mënyrë që shkon tek shtëpia e të dëmtuarit e futet brenda në korridor dhe me kokë fillon të godas murin e korridorit me grushta e shqelma orenditë dhe pajisjet, ku i dëmton e del nga aty e shkon në shtëpinë tjetër në të cilin jeton së bashku me vëllain A. dhe aty vazhdon që të demolojë dhomat e orenditë e shtëpisë.

II

Sepse, me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin I (një) të këtij aktgjykimi, vëllait të tij me të cilin jeton në një shtëpi të përbashkët, të dëmtuarit A. H. i shkakton dëm material në shtëpi, në atë mënyrë që kur kthehet, nga shtëpia e vëllait të tij M., shkon në shtëpinë ku banon së bashku me A. e futet brenda në shtëpi e shkon në dhomën e gjumit ku edhe aty me shqelma dhe grushta i godet orenditë dhe pajisjet e tjera shtëpiake e shkakton dëm material, ashtu që ndërhyjnë vëllezërit tjerë e ndalojnë dhe të njëjtin ia dorëzojnë Policisë.

- Me këtë ka kryer veprën penale të asgjësimit apo dëmtimit pasurisë, në vazhdimësi, nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

III

Me datë, kohë e vend si në dispozitivin I (një) të këtij aktgjykimi, e përdor forcën fizike pa pëlqimin e vëllait të tij të dëmtuarit K. H. mundohet që të ndërprejë veprimet demoluese e të qetësoj të akuzuarin, i akuzuari e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur pjesëve të trupit me grushta, e ndërhyjnë vëllezërit e tjerë dhe arrijnë ta vejnë gjendjen nën kontroll derisa të vijnë Policia

-Me këtë ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40 par. 1 pika 1.3, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin H. H., për veprën penale asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë, në vazhdimësi, nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej **katërqind (400) Euro**, dhe

- Për veprën penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së, e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej **katërqind (400) Euro**, të cilin dënim është i obliguar të paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **katërdhjetë (40) ditëve**, duke llogaritur një (1) ditë burgim njëzet (20) €.

Koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.11.2018 deri më 24.12.2018, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar si më lartë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, ashtu që:

- Në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) Euro, dhe
- Për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit: M. H. dhe K. H. që të dy nga Rahoveci, Rr. "Sh. Z.", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

I dëmtuari A. H., nga Rahoveci, Rr. "Sh. Z.", p.nr., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore e Gjakovës – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën, PP.nr.1759/2018 të datës 26.12.2018, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin H. H., nga Rahoveci, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, në vazhdimësi, nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale të sulmit neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me datë 19.01.2021, dhe në këtë shqyrtim kanë qenë të pranishëm: Prokurori i Shtetit Kastriot Memaj, i akuzuari H. H., si dhe i dëmtuari A. H., ndërsa nuk kanë qenë të pranishëm të dëmtuarit M. H. dhe K. H..

Prokurori i shtetit pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së, në nenin 184 par.1 të KPRK-së, (KODI NR.06/L-074), dhe ka qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprakisht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i ngarkohet.

I akuzuari H. H., ka deklaruar se: E pranon fajësinë për veprën për të cilën akuzohet, dhe ka shprehur keqardhje për veprat të cilët i ka kryer, por këtë e ka bërë pasi që në ato momente ai ka qenë i nervozuar me vëllezërit e tij, por e ka njoftuar gjykatën se, menjëherë pas këtij rasti ai i ka kërkuar falje vëllezërve, janë pajtuar, jetojnë së bashku në të njëjtën shtëpi dhe nga ajo kohë dhe deri më sot nuk kanë pasur probleme tjera. Ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të ketë parasysh të gjitha këto rrethana e sidomos mënyrën se si e ka kryer veprën penale, e po ashtu edhe faktin se ata veç e kanë tejkaluar këtë mosmarrëveshje, kështu që e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjykata, e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, dhe të dëmtuarit, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Kastriot Memaj, ka theksuar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu, i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë, të njëjtin ta shpallë fajtor, dënojë në bazë të ligjit, si dhe ta obligoj në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

I dëmtuari A. H., ka deklaruar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, e po ashtu nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, pasi që të njëjtin e ka vëlla, janë pajtuar dhe jetojnë së bashku.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë në vazhdimësi, nga neni 33 par. 1 të, lidhur me nenin 81 KPRK-së, dhe veprën penale të sulmit nga neni 184 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Deklarata e të dëmtuarit M. H., e dhënë në Polici e PTH-Gjakovë, me dt.18.12.2018;
- Deklarata e të dëmtuarit K. H., e dhënë në Polici e PTH-Gjakovë, me dt.18.12.2018;
- Deklarata e të dëmtuarit A. H., e dhënë në Polici e PTH-Gjakovë, me dt.18.12.2018;
- Alkool Testi, i dt.25.11.2018;
- Raporti i shkurt, i dt.25.11.2018;
- Raporti i oficerit, dt.25.11.2018;
- Raporti emergjent i QKMF-Rahovec, i dt.25.11.2018;
- Raporti emergjent i spitalit Rajonal "Prim. Dr.D. M.", Prizren, i dt.26.11.2018;
- Vërtetim mbi marrjen e sendit, i dt.09.08.2016 si dhe
- Foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera në lëndë, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimin të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk ka gjetur, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, se është hera e parë që kishte rënë ndesh me ligjin, i njëjti në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, kërkim faljen, e mbi të gjitha si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin se ishte në gjendje të dehur, i pavetëdijshëm për veprimet e tij, i njëjti është pajtuar me të dëmtuarit dhe jetojnë në një shtëpi të përbashkët, dhe nga ajo kohë nuk kanë pasur më probleme, se i dëmtuari A. H., nuk i është bashkëngjitur ndjekjes, si dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari e ka kryer veprën penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi me gjobë, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale-paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6, lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së, ndërsa

vendimi për kompensimin e viktimave u mor në kuptim të nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Në bazë të nenit 463 par. 1 dhe par. 2 të KPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
- Divizioni Penal -
P.nr.1/2019, datë 21.01.2021.

Sekr. juridik,
Shani Canziba

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ilir Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.